



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr.2248/5 Prot.

Tiranë, më 04.11.2020

**VENDIM- QARKULLUES**

Nr.46, datë 04.11.2020

**PËR**

**MIRATIMIN E HAPJES TË PROGRAMIT TË CIKLIT DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË “INFIERMIERI FAMILJE” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE, UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të nenit 35, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 35, 38 dhe 73 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Vendimin e Senatit Akademi nr. 86, datë 07.10.2020 “Për miratimin e programit të ri të studimit “Master Profesional në Infermieri Familje”, në Fakultetin i Shkencave Mjekësore Teknike, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” dhe informacionin e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me nr. 2248/4 Prot., datë 27.10.2020 “Vlerësim i kostos financiare, për programin e ri të studimeve, Master Profesional në Infermieri Familje” Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional në Infermieri Familje”, në Fakultetin i Shkencave Mjekësore Teknike”.
2. Efektet financiare të hapjes së progamit “Master Profesional” në “Infermieri Familje”, në Fakultetin i Shkencave Mjekësore Teknike përballohen nga të ardhurat e institucionit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**KRYETARI  
FLORIAN TOTI**

